

Njoftimi i përqendrimit me të cilin Xhenertelajf S.p.A. Itali, Zhenerali Vie S.A., Francë, Xhenerali Italia S.p.A. Itali, Generali Dojçland AG Gjermani, Aleanca Asiguracioni S.p.A. Itali dhe Munhener Rukferziherungs-Gezellschaft Aktienhezellshaft in Munhen Gjermani do të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale

(lënda nr. 08-141/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 21.10. 2022, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës pranoi njoftimin e përqendrimit me të cilin Xhenertelajf S.p.A. (Genertellife S.p.A.), me seli të regjistruar në Molano Veneto (TV), Via Marokesa 14, Kodi Postar 31021, Itali (Mogliano Veneto (TV), Via Marocchesa 14, CAP 31021, Italy) ("Xhenertellajf"); Zhenerali Vie S.A. (Generali Vie S.A.), me seli në Pilet-Vill 2, 75009 Paris, France (Pillet-Ville 2, 75009 Paris, France) ("Zhenerali Vie"); Xhenerali Italia S.p.A. (Generali Italia S.p.A.), me seli të regjistruar në Molano Veneto (TV), Via Marokesa 14, Kodi Postar 31021, Itali (Mogliano Veneto (TV), Via Marocchesa 14, CAP 31021, Itali) ("Xhenerali Italia"); Generali Dojçland AG (Generali Deutschland AG), me seli të regjistruar në Adenauering 7-9, 81737 Munih, Gjermani (*Adenauerring 7, 81737 Munich, Germany*) ("Generali Dojçland"); Aleanca Asiguracioni S.p.A. (Alleanza Assicurazioni S.p.A.), me seli të regjistruar në Pjaca Tre Tori 1, 20145 Milano, Itali (*Piazza Tre Torri 1, 20145 Milano, Italy*) ("Aleanca") dhe Munhener Rukferziherungs-Gezellschaft Aktienhezellshaft in Munhen (*Münchener Rückversicherungs-Gesellschaft Aktiengesellschaft in München*), me seli në Koeniginsstrase 107, 80802 Munih, Gjermani (Koeniginstrasse 107, 80802 Munich, Germany) do të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale.

Të gjithë Shitësit janë (drejtpërdrejt dhe/ose indirekt) në pronësi dhe kontrollohen nga Asiguracioni Xhenerali S.p.A., Itali, (*Assicurazioni Generali S.p.A., Italy*) shoqëria mëmë e një grupi ndërkombëtar shoqërisht, aktive në sektorin e sigurimeve dhe financave ("**Generali**"). Shitësit menaxhojnë biznesin e Generali në Itali (Xhenerali Italia, Aleanca dhe Xhenertelajf), Gjermani (Generali Dojçland) dhe Francë (Zhenerali Vie). Generali ka një ndërmarrje-bijë në Maqedoninë e Veriut, shoqëria Generali Investments SHA Shkup me seli në bul. Partizanski odredi 14A-1/2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, me objekt funksionimi: Veprimtaritë e menaxhimit të fondeve.

Mjunih Re është një shoqëri ndërkombëtare sigurimesh. Mjunih Re mbulon të gjithë zinxhirin e vlerës së ri-sigurimeve, sigurimit primar dhe zgjidhjeve të rrezikut të sigurimit dytësor, si dhe ofron shërbime të menaxhimit të mjeteve.

Shoqëria e synuar është një shoqëri investimi në pasuri të paluajtshme, e cila zotëron një pasuri të paluajtshme unike, të drejtën e qirasë në rrugën Fençrç nr. 120, Londër, MB (120 Fenchurch Street, Londër, MB), ku ndodhet një ndërtesë 15-katëshe me përafërsisht. 40 000 m2 ambient biznesi dhe tregtimi. Nuk ka prani në RMV.

Tregu relevant

Transaksioni i propozuari referohet kryesisht me sektorin e pasurive të paluajtshme, veçanërisht dhënien me qira të pasurive të paluajtshme komerciale dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme. Nga pikëpamja gjeografike, tregjet relevante janë të kufizuara në territorin e MB.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

26.10. 2022

Shkup